

NË KAÇANIK ËSHTË DEBATUAR PËR EKZEKUTIMIN E BUXHETIT KOMUNAL TË 2011-S

# Kaçanikasit duan transparencë më të madhe për tenderët

Ekrem Raka

KAÇANIK, 10 SHKURT - Komuna duhet të jetë më transparente në procesin e realizimit të projekteve kapitale nga çasti i marrjes së vendimit për hapjen e procedurave tenderuese e deri në finalizimin e tyre. Ky ka qenë njëri nga konkluzionet e debatit të organizuar nga projekteti Zvicër-Kosovë për qeverisje lokale dhe decentralizim - LOGOS, dhe Komuna e Kaçanikut, të premten, me temën: "Ekzekutimi i buxhetit komunal të 2011-s". Komunës i është sugjeruar që nga punëkryesit të kërkojë garanci për një periudhë të caktuar për projektet që ato i realizojnë me mjete të taksapaguesve. Në këtë kontekst është thënë se në disa raste projektet janë realizuar pa cilësinë e duhur. Nga Qeveria e Kosovës është kërkuar që t'u lejojë komunave të themelojnë fonde për intervenim në situata emergjente. Janë dëgjuar edhe akuza në adresë të ekzekutivit komunal për shpenzime enorme për telefona, karburant dhe dreka zyrtare. "Komuna ka buxhet të vogël për shpenzime kaq të mëdha", ka theksuar Shukri Luta, këshilltar jopartiak komunal. Kreu i Komunës, Xhabir Zharku, ka deklaruar se në asnjë rast nuk ka pasur keqpërdorim të parashë



komunale. "Vjet kemi bërë reduktime në shpenzime, ndërsa mjetet janë shpenzuar vetëm për punë zyrtare", ka thënë ai. Në hapje të debatit, Fikri Vërbani, drejtor i Drejtorisë së Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, i ka njoftuar të pranishmit lidhur me ekzekutimin e buxhetit të vitit fiskal 2011. "Janë shpenzuar

5.592.588 euro ose 96,2 për qind e totalit të buxhetit në dispozicion (5.816.049 euro)", ka thënë Vërbani. Rrjedha e debatit është vlerësuar nga organizatorët. "Ishte një debat i mirë me diskutime dhe sugjerime domethënëse", ka thënë Norbert Pijls, koordinator i projektit LOGOS, që financohet nga Qeveria zvicerane.

11.02.2012